

Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, Departamenti i Gjeologjisë së Zbatuar dhe i Gjeoinformatikës shpall 1 (një) vend pune për personel akademik me kohë të plotë të kategorisë Lektor pranë Grupit-Mësimor-Kërkimor të Gjeologjisë Inxhinierike dhe Hidrogeologjisë, profili Gjeologji Inxhinierike:

Kriteret që duhet të plotësojë kandidatët janë:

- Të ketë mbaruar studimet në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, në sistemin 5 (pesë) vjeçar në Degën Gjeologji me profil Gjeologji Inxhinierike (Gjeoteknikë)-Hidrologji ose në sistemin e studimeve 3+2 (Bachelor + Master Shkencor) në Degën “Inxhinieria Gjeologjike” Profili “Gjeologji Inxhinierike –Hidrogeologji” me notë mesatare ≥ 8.5 (e barabartë ose më e madhe se tetë pikë pesë), ose të jetë diplomuar jashtë shtetit dhe diploma të jetë ekuivalentuar në të njëjtin profil.
- Të ketë së paku gradën “Doktor” në fushën e Gjeologjisë Inxhinierike - Hidrogeologjisë.
- Të zotërojë një gjuhë të huaj: anglisht, gjermanisht, frëngjisht, italisht (me dëshmi) ndër të cilat preferohet e para.
- Të ketë eksperiencë në fushën e Gjeologjisë Inxhinierike – Hidrogeologjisë.
- Të zotërojë dhe të përdorë lehtësisht programe kompjuterike profesionale.

DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Të gjithë kandidatët që aplikojnë duhet të paraqesin brenda datës **04.03.2022** pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Kopje e Diplomës Master i Nivelit të Dytë ose “DOKTOR” të noterizuar, në rast se ka. (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
6. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
7. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
10. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.